



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

24 Janar 2019

RAPORT

Mbi monitorimin e pjesshëm të pasqyrimin në media të procesit të “Vettingut”

Gjetjet kryesore

Të gjitha mediat në vendin tonë, pa përjashtim, e kanë pasqyruar procesin e vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Por duhet theksuar se janë të pakta ato media që janë përpjekur ta kuptojnë dhe ta shpjegojnë atë, në mënyrë profesionale, duke bërë edhe thellimet përkatëse, por njëkohësisht duke respektuar në lajmin e transmetuar etikën gazetareske dhe të drejtat dhe dinjitetin e personave (gjyqtarëve dhe prokurorëve) që i nënshtrohen këtij procesi. Një pjesë janë marrë vetëm me fenomene të caktuara, të cilat i kanë pasqyruar sipas një optike ngushtësisht personale apo për shkak edhe të polarizimeve të natyrës edhe politike.

Nisur nga rëndësia e madhe që ka procesi i vettingut, i cili ka një interes të lartë për publikun, vlerësojmë se media duhet të jetë shumë e përgjegjshme në përcjelljen e lajmit dhe çdo rast mediat duhet të kenë prioritet informimin e publikut dhe dhënien e informacioneve të vërteta. Përpjekja e tyre për të qenë gjithnjë e më shumë gjeneraliste me dëshirën për të pasur audienca sa më të gjëra, bën që mediat të raportojnë gjithnjë e më pak lajme që kanë të bëjnë me të dhëna të rëndësishme siç janë statistikave lidhur me ecurinë e procesit të vettingut. Ato fokusohen më shumë në dhënien e informacioneve apo lajmeve të cilat bëjnë sensacion dhe shtojnë audiencën sesa në cilësinë e lajmit.

Ndërkaq media në shumë raste është bërë edhe promotore dhe nxitëse e pjesëmarrjes së publikut në këtë proces, pasi të gjithë mund të bëhen pjesë e tij përmes denoncimeve. Nuk është vënë re, ndërkohë, ndonjë shkrim në lidhje me efektet që “denoncimet nga publiku” mund të kenë pasur në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi procesin e vettingut. Shkrime të tilla mund të kishin vlerë nxitëse të mëtejshme, përveçse informuese.

Për më shumë informacion, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ju fton të njiheni me raportin e monitorimit të pjesshëm të medias në vijim, të realizuar në kuadër të nismës “Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e vettingut – Projekti nr.2”, mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

A njeh media procesin e vettingut?

Reforma në drejtësi është një nga zhvillimet më të rëndësishme të ndodhura vitet e fundit në nivel kombëtar dhe vijon të komentohet edhe në arenën ndërkombëtare.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Pa dyshim që media ka dhënë dhe vazhdon të jap kontributin e saj në funksion të pasqyrimin të procesit të vettingut dhe seancave dëgjimore të kryera me subjektet e rivlerësimit, por edhe në pasqyrimin e ecurisë së Reformës në Drejtësi në tërësi. Artikujt e gazetave, lajmet dhe reportazhet televizive, janë sot mjeti kryesor i informimit të publikut në lidhje me aktualitetin, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por në shumë raste rezulton se verifikimi i informacioneve që publikohen në mediat online, por edhe ato tradicionale është një praktikë në zhdukje. Mjafton të shohësh një shkrim apo artikull në një portal dhe pa hezitim, i njëjti shkrim bën xhiron e të gjitha portaleve simotra, lajmet thjesht botohen, riprodhohen fjalë për fjalë në shumë media tradicionale dhe online, nuk verifikohen dhe kjo gjë ka mpakur rolin e gazetarëve si rojtarë dhe gjithashtu ndikon në saktësinë e informacionit të marrë nga publiku.

Media ka qenë shumë e ndjeshme dhe e vëmendshme ndaj të gjitha ngjarjeve duke i pasqyruar ato në kohë reale. Është fakt që procesi është ndjekur mediatikisht që në zanafillën e tij. Sigurisht, përveç transmetimit të ngjarjeve më kulmore në kohe reale, reforma ka gjetur pasqyrim të vazhdueshëm në edicionet qendrore të lajmeve, thellimet e mëtejshme, intervistat me personat kyç, reportazhe dhe shkrime në median e shkruar dhe portale.

Cilësia e një produkti mediatik varet nga cilësia e medias dhe profesionalizmi i gazetarëve. Në rastin e vettingut, bëhet fjalë për një proces të ri, kompleks dhe me raste edhe me paqartësi juridike dhe procedurale qoftë edhe në radhët e ekspertëve të ligjit që jo rrallë kanë qenë pjesë e debateve dhe përplasjeve. Kjo ka rritur shkallën e vështirësisë së pasqyrimin korrekt, të paanshëm dhe profesional të dinamikës së procesit. Ka pasur media që sigurisht kanë bërë raportime korrekte, sikundër edhe të tjera që kanë bërë raportime të cingëruara, në shkelje të parimeve gazetareske, apo edhe raste kur gazetari në vend që të luajë rolin e “dëshmitarit” të një ngjarjeje në kërkim të rrëfimit të së vërtetës, ka luajtur rolin e një PR (eksperti të marrëdhënieve me publikun).

Ajo që vihet re, gjithsesi, në krahasim me fillimin e procesit është rritje e cilësisë së pasqyrimin, kjo edhe falë përvojës, së fituar tashmë me të.

Edhe gjatë pjesës së dytë të vitit 2018 procesi i vettingut ka qenë shumë prezent në median elektronike dhe tradicionale, duke e cilësuar atë si një nga ngjarjet më të rëndësishme të vitit. Kryesisht është folur për mos krijimin e institucioneve përkatëse sipas ligjit, për zvarritjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku mbizotërojnë “rrëzimet” e figurave të rëndësishme të gjyqësorit, shumica e të cilëve patën probleme me deklarin e pasurisë.

Hapësirën më të madhe e ka zënë “rrëzimi” i prokurorëve, apo gjyqtarëve. Këtu janë vënë re edhe interpretime nga më të ndryshmet. Ka mes tyre që largime të individëve të caktuar i konsiderojnë si vendime “të njëanshme”. Ndoshta kësaj pjese të procesit i është dhënë më shumë rëndësi edhe për faktin se emrat e përveçëm, për më tepër kur bëhet fjalë për gjyqtarë dhe prokurorë, konsiderohen nga media si më “të shitshëm” për publikun.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Janë analizuar gjerësisht rastet e vettingut të anëtarëve të gjykatës Kushtetuese dhe të së lartë, të cilët kanë gjetur një jehonë të madhe në media, kjo për shkak se të dyja këto gjykata u shpërbënë gjatë procesit të vettingut, për shkak të dorëheqjeve apo edhe shkarkimeve nga komisioni i posaçëm i kualifikimit.

Kemi raste kur i njëjti lajm jepet në këndvështrime të ndryshme, duke vendosur publikun para dyshimit mbi vërtetësinë e fakteve të referuara në këtë lajm. Për shembull në rastin e pasqyrimin të një seance vendimi gazeta Telegrafi.com referon se KPK shkarkon R.G, pasi ajo nuk ka justifikuar pasurinë e saj dhe ka bere deklarim te pasaktë të pasurisë. KPK dyshon se rezultojnë xx apartamente në Durres të R.G por ajo pretendon se janë ne emrin e babit te saj, administrator i pallateve. Gjithashtu nën hetim është edhe bashkëshorti i saj. Ndërsa portali Lapsi.al refero për të njëjtin lajm se sipas tyre ka dështuar seanca e vettingut për prokuroren R.G, që nuk u paraqit me pretendimin se tashmë vendimi për të është marrë dhe se vettingu është kthyer në një arenë e diskreditimit publik të njerëzve të drejtësisë. Ndërkohë gazeta online Panorama.al, raporton: R.G ish drejtoresha e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe e dekriminalizimit si dhe bashkëshorti i saj D.G, ish prokuror i qarkut të Elbasanit, janë vendosur zyrtarisht nën hetim. Çifti i bashkëshortëve prokuror janë duke u hetuar për tri vepra penale. Pastrim të produkteve te veprës penale te parashikuar nga neni 287 i kodit penal: fshehje te pasurisë në bashkëpunim dhe për deklarim të rremë të pasurisë pranë organeve zyrtare.

Kontributi i medias në nxitjen e publikut për të bashkëpunuar për vettingun

Publiku mund të bëhet aktor i rëndësishëm në procesin e vettingut ndaj çdo gjyqtari apo prokurori, ndaj të cilit posedohen të dhëna komprometuese që nga korrupsioni, fshehja e pasurisë, kontaktet me individë që i përkasin krimit të organizuar e deri tek shkelja e etikës dhe zvarritja e proceseve nga njerëzit e drejtësisë nëpërmjet KPK (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit) i cili është një organ kushtetues, veprimtaria e të cilit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Media në vazhdimësi ka publikuar¹ jo vetëm fillimin e procesit të bashkëpunimit të organeve të vettingut me qytetarët por edhe publikimin e formularit të ankesave, si dhe ku duhet të drejtohen qytetarët për të drejtuar ankesat e tyre. Jehona publike që media i ka dhënë këtij procesi ka dhënë rezultate të mira në publik që në fazat e para. Kjo për shkak të numrit mjaft të madh të denoncimeve të dërguara nga publiku, rreth 2140 denoncime² që nga fillimi i procesit, Tetor 2017 e deri në fund të muajit Nëntor 2018. Nuk është vënë re, ndërkohë, ndonjë shkrim në lidhje me efektet që “denoncimet nga publiku” mund të kenë pasur në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi procesin e vettingut. Shkrime të tilla mund të kishin vlerë nxitëse të mëtejshme, përveçse informuese.

¹ <http://www.panorama.com.al/vetingu-i-gjyqtareve-dhe-prokuroreve-kpk-njoftim-me-rendesi-kerkon-ndihmen-e-qytetareve/>
<https://www.botasot.info/shqiperia/892355/nxitje-e-pjesemarrjes-se-publikut-ne-procesin-e-vetingut/>
<http://top-channel.tv/2017/11/21/denoncimet-e-qytetareve-kpk-sndryshojne-vendimet-e-dhena-nga-gjykatat/>
<https://www.youtube.com/watch?v=z0QOwh7dpBk>
<https://sot.com.al/politike/bum-ankesash-ne-kpk-1017-denoncime-nga-qytetaret-prokuroret-dhe-gjyqtaret-brenda-7-muajve>

² <http://kpk.al/wp-content/uploads/2018/11/Regjistri-i-denoncimeve-ne-KPK.pdf>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Po nuk mbeten pas edhe pasqyrimet në media të përfundimeve apo gjetjeve të dala nga studime³, monitorime⁴ dhe raporte⁵ të ndryshme të realizuara nga shoqëria civile në lidhje me ecurinë e zbatimit të procesit të vettingut në Shqipëri. Pasqyrime të cilat kanë ndihmuar në procesin e informimit të publikut në mënyrë transparente dhe të plotë të qytetarëve jo vetëm mbi vazhdimësinë procesit por edhe mbi transparencën e tij dhe skedat e të ardhurave personale të subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, duke u dhënë në këtë mënyrë mundësinë qytetarëve të informohen për rastet konkrete të Vettingut dhe të vlerësojë në opinionin e vet procesin e Vettingut në tërësi.

Kritikët ndaj medias në pasqyrimin e vettingut!

Nuk mungojnë edhe rastet kur media atakohet nga gazetarë të ndryshëm, apo portale të cilat pretendojnë se këto media e shtrembërojnë pasqyrimin e këtij procesi në mediat e tyre për interesa të ngushta⁶ apo edhe raste kur media pasqyron në mënyra të njëanshme opinionet e politikës mbi politizimin e reformës në drejtësi dhe në veçanti të procesit të vettingut, ku theksi iu jepet opinioneve të palëve të ndryshme politike mbi ecurinë e procesit.

Pasqyrimi mediatik profesional i vettingut

E ndërsa procesi i vettingut pasqyrohet pak a shumë i plotë në të gjitha mediat, për sa i takon pasqyrimeve më të plota dhe në formë analitike, duke nxjerrë në pah edhe problematikat, ato hasen më rrallë. Sigurisht bëhet fjala për gazetarë të vjetër dhe me përvojë. Raportime të kësaj natyre janë të rralla. https://www.youtube.com/watch?v=eZSeI_Zgwvc

Ka edhe media të cilat merren me elementë të veçantë të reformës në drejtësi, përmes investigimeve dhe thellimeve të aspekteve të ndryshme të procesit të vettingut. Kjo pa dyshim që është një punë cilësore, që kërkon ekspertizë dhe kohë dhe që përcjell te publiku materiale unike që zgjerojnë perceptimin e tij, pikërisht për këto elementë të veçantë. <https://www.reporter.al/skeda-e-pasurise-se-deklaruar-izet-kadana-kryetar-i-gjykates-puke/>

<http://www.kohajone.com/2018/06/30/presionet-politike-kercenojne-besimin-publik-te-reforma-ne-drejttesi/>

Kemi edhe media që me të drejtë japin hapësirë dhe zë kundërshtarëve të reformës për të paraqitur argumentet e tyre.

³ <https://lapsi.al/2018/08/09/raporti-per-komisioneret-e-vetingut-kush-po-shkarkon-me-shume-gjykates/>

⁴ <http://www.oranews.tv/article/raporti-i-dsik-200-gjyqtare-e-prokurore-te-lidhur-me-krimin>

⁵ <http://www.oranews.tv/article/skeda-e-pasurise-se-deklaruar-elsion-sadiku-prokuror-i-prokurorise-se-korces>

⁶ <https://hashtag.al/index.php/2018/06/07/vetingu-top-channel-ve-ne-shenjester-gjyqtaret-qe-nuk-i-perulen-vjollca-blushit/>
<http://www.panorama.com.al/forca-e-medias-online/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:ZTigZkSZZKoJ:revista.mapo.al/labirinti-i-drejtewise/+&cd=50&hl=en&ct=clnk&gl=al>

Në përfundim,

mund të thuhet se edhe në lidhje me pasqyrimin e procesit të vettingut, hapave të tij, veçorive, problematikave dhe sigurisht gjithë personazheve që janë pjesë e tij, media nuk mund të dalë nga mundësitë dhe situata tërësore në të cilën ndodhet. Kjo bën që raportimet të jenë të shumta, jo gjithmonë profesionale, jo gjithmonë të përcjella me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, dhe shumë rrallë thelluese dhe analitike. Por krahasuar me periudhën e fillimit të procesit, deri në korrik 2018 raportimet janë përmirësuar ndjeshëm.